



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 18.09.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

Mbi

Projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18.09.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për Ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Arben Pëllumbi.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

II. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 78 dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 68, të Rregullores së Kuvendit si dhe në

përmbyshje të nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, shpjegoi se, projektligji vjen pas miratimit në parim të marrëveshjes së huas me vendimin e Këshilli të Ministrave nr. 303, datë 23.5.2018, duke haur rrugën kështu ratifikimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, të nënshkruar tashmë prej palëve.

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për akordimin e një financimi shtesë në vlerën 12 milionë euro.

Kjo shtesë e dytë e financimit, përbën fazën e pestë të programit dhe konsiston në 2 pjesë:

Pjesa 1. Investime në infrastrukturën e sigurisë së digave, konsiston në sigurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve për masat korrigjuese me prioritet shumë të lartë për digat, duke përfshirë:

- rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe të portave segmente të sigurisë të Hidrocentralit të Fierzës dhe të Komanit.
- rehabilitimin e pajisjeve elektromekanike të Hidrocentralit të Komanit dhe modernizimin e departamentit të sigurisë së digave.

Pjesa 2. Asistencë teknike dhe trajnim për sigurinë e digave konsiston në:

- Sigurimin e shërbimeve të konsulencës për menaxhimin e ujëmbledhësve lumorë të Drinit dhe Matit, optimizimin e prodhimit të energjisë dhe menaxhimit të burimeve ujore, përmirësimin e kapacitetit të menaxhimit financiar përfshirë aktivitetet e projektimit dhe mbikëqyrjes.
- Sigurimin e shërbimeve të konsulentëve për Panelin e Ekspertëve të pavarur.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë evidentuan faktin se kjo marrëveshje do të mundësojë rritjen e sigurisë së digave të hidrocentraleve në kaskadën e lumejve Drin dhe Mat, përmirësimin e efikasitetit të shfrytëzimit të këtyre digave hidroenergjitike dhe rritjen e sigurisë e cilësisë së furnizimit me energji elektrike me impakt në rritjen e qëndrueshme të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë elektrike.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sqaruan se në terma financiarë, huaja është në vlerën 12 milion euro me interes, të bazuar në normën e referencës plus marzh të pandryshueshëm. Tarifa fillestare është 0.25% e shumës së huas ndërsa komisioni i angazhimit është në masën 0.25% në vit të tepricës së pa tërhequr të huas. Maturimi i huas është 23 vjet duke përfshirë periudhën prej 7 vitesh, e cila është pa pagesë principali.

Zbatimi i projektit do të bëhet nga KESH, sh.a.-ja, deri më 31 dhjetor 2020, të cilës do ti nën-huazohet fondi i kredisë, me të njëjtat terma përmes një marrëveshjeje specifike. Projekti është brenda parashikimeve buxhetore të KESH për periudhën 2018 - 2021.

Në përfundim Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar pozitive dhe me interes këtë marrëveshje në funksion të rritjes së sigurisë së digave të hidrocentraleve në kaskadën e lumejve Drin dhe Mat si dhe përmirësimin e efikasitetit të shfrytëzimit të tyre me votat pro të gjithë të pranishmëve e miratoi projektligjin.

Relator

Arben Pëllumbi

Kryetar

Erion BRAÇE